

## SYLLABUSI

**Universiteti i Prishtinës**

**Fakulteti i Filologjisë, Dega:** Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

**Titulli i kursit:** Gjuhët në kontakt: gjermanishtja dhe shqipja

**Niveli dhe lloji i kursit:** Bachelor; lëndë mësimore zgjedhore

**Viti i studimeve dhe semestri:** viti III, semestri V

**Kodi ose shifra e lëndës:**

**Vlera në kredi:** 5

**Koha/lokacioni:** Viti akademik 2013/2014

**Mësimdhënësi i kursit:** PD Dr. Gerd-Dieter Nehring

Tel.: 049781578,

E-mail: dieter.nehring@cms.hu-berlin.de

### **Qëllimet e kursit:**

Qëllimet e ligjëratis janë që të njihen studentët me:

- objektin e lëndës, me lidhjet e saj ndaj disiplinave të tjera, si dhe me literaturën përkatëse të lëndës dhe me rëndësinë, që ka lënda në fushën shkencore dhe për krijimin e lidhjeve më të ngushta mes popujve të ndryshëm dhe vendeve të tyre.
- çështjet themelore të disiplinës, duke përfshirë aspekte të shtrirjes dhe të statusit të ndryshëm të gjermanishtes dhe të shqipes si dhe etapat kryesore të historisë së gjuhësisë dhe të kulturës gjermane.
- rezultatet e kontaktit gjuhësor në standardin e sotëm gjerman në vendet ku gjuha gjermane e ka statusin e gjuhës zyrtare në nivel të një shteti.
- gjendjen dhe historinë e gjuhës gjermane në rrethe ku gjermanishtja e ka statusin rajonal të gjuhës zyrtare apo statusin e gjuhës së një minoriteti.
- formimet kreole dhe pidgin si dhe me ndikimin e gjermanishtes në gjuhët e Ballkanit.

### **Rezultatet e pritura të nxënies**

Pas përfundimit të ligjëratis studenti do të jetë në gjendje: që

1. të këtë njohuri të mira mbi lëndën e ligjëratis,
2. të mund të gjykojë në mënyrë profesionale çështje themelore të kontaktit gjuhësor,
3. ta ndjekë literaturën e lëmit dhe
4. të orientohet mirë dhe me përgjegjësi në punën e ardhshme shkencore si dhe në punën praktike, sidomos në kulturën e gjuhës.

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	22.5
Ushtrime teorike/laboratorike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokfiume,seminare	5	2	10
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	10	1	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet,prezentimet ,etj	30 min	1	0.5
<b>Totali</b>			<b>122.5:25 = 4.9 5 ECTS</b>

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

- ligjërata
- studim vetjak dhe në grupe
- prezantime.

### **Literatura bazë:**

- Els Oksaar: Prinzipien und Methoden der sprachlichen Interferenz- und Transferenzforschung. In: Besch/ Reichmann/ Sonderegger (Hrsg.): Handbücher zur Sprach- und Kommunikationswissenschaft (HSK). Berlin 1986, S. 662–669
- Els Oksaar: Terminologie und Gegenstand der Sprachkontaktforschung. In: Besch/ Reichmann/ Sonderegger (Hrsg.). Handbuch zur Sprach- und Kommunikationswissenschaft (HSK). Berlin 1986, S. 845–854

- Claudia Riehl: Sprachkontaktforschung. Eine Einführung. Tübingen 2004
- Carlo Tagliavini: Einführung in die romanische Philologie. 2. Auflage. Basel/ Tübingen 1998, ISBN 3-8252-8137-X (UTB), ISBN 3-7720-2259-6 (Francke)
- Uriel Weinreich: Sprachen in Kontakt. Ergebnisse und Probleme der Zweisprachigkeitsforschung. München 1977 (dt. Übersetzung des Buches von 1953).
- Wieser Enzyklopädie des Europäischen Ostens. Hrsg. v. M. Okuka u.a. Klagenfurt/Celovec 2002.

**Plani i detajizuar i mësimit për një semester:**

Java	Thema
	KONTAKTI GJUHËSOR:
1	Gjurmime në fushën e kontaktit gjuhësor: Objekti dhe lidhjet me disiplina të tjera.
2	Nocionet kryesore të lëndës si dhe literatura kryesore. Gjuhët kreole dhe pidgin.
3	Llojet e kontakteve gjuhësore në shembullin e gjuhëve botërore, të gjuhës gjermane si dhe të shqipes.
4	Gjuha gjermane në Evropë dhe përtej oqeanit: statusi i gjermanishtes si dhe mundësitë kryesore të kontaktit gjuhësor.
5	Kontakte gjuhësore në historinë e gjuhës gjermane.
6	Purizmi në historinë e gjuhës gjermane deri më sot.
	TEST
7	Fjalët e huaja dhe internacionalizmat në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe.
8	Rëndësia e gjuhëve klasike në zhvillimin e gjermanishtes dhe të shqipes.
9	Anglicizmat në standardin gjerman. Llojet sipas niveleve gjuhësore.
10	Kontakti gjuhësor i bartësve të gjermanishtes në Tirolin e Jugut.
11	Gjermanët në Rusi dhe kontakti i tyre me rusishten gjatë historisë.
12	Gjermanët e Rusisë në Gjermani sot. Kontakte gjuhësore-kulturore.

13	Ndikimi i gjuhës gjermane në gjuhët e sllavëve të Jugut.
14	Kontakte kryesore të shqipes me gjuhë të tjera nga aspekti i gjuhës standarde.
15	Situata gjuhësore në Kosovë dhe kontakte me gjuhën gjermane: prezantime.

**Metodat e vlerësimit:**

- Testi i parë me shkrim 15%
- Prezantim 25%
- Provimi final me shkrim 50% (pa prezantim 75%)
- Pjesëmarrja 10%.

**Provimet:**

Kusht për pjesëmarrjen në provimin final gjatë afatit të provimeve janë pjesëmarrja në ligjëratat dhe testet. Studentët që shquhen për pjesëmarrjen në ligjëratë si dhe për testet e suksesshme, u jepet mundësia e zëvendësimit të provimit. Në atë rast duhet të thellojnë me shkrim (15 f.) një prej temave të ligjëratave. Zëvendësimi bëhet në bazë të marrëveshjes me mësimdhënësin. Punimi duhet të paraqitet gjatë kohës së ligjëratave si kolokuim me prezantim.